VENDIM
Nr. 103/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 102/2017 "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore", të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

I. Në pikën V, bëhen këto ndryshime:

1. Përbërja e komisionit ndryshon, nga 12 anëtarë, në 14 anëtarë.

2. Caktohen anëtarë të komisionit:

Z. Adnor Shameti (PS);

Z. Adriatik Alimadhi (GPPDj).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 12.9.2019